



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA
KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË
MUNICIPAL OF ASSEMBLY- SUHAREKË
SKUPSTINA OPSTINE SUVA REKA



Në bazë të nenit 12, 17, 24 dhe 40, paragrafi 2, pika (b), të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr-03/L-040, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008", e në mbështetje të dispozitave të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal, Nr-03/L-049, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-27/2008," e konform nenit, 28, paragrafi 2, pika (b), 29, paragrafi 2, pika (c) dhe 56, të Statutit të Komunës në Suharekë, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e mbajtur me datë 29.04.2025 miratoi këtë:

V E N D I M

Për përmbushjen dhe tejkalimin e planit buxhetor të të hyrave vetanake për vitin fiskal 2024 në shuma prej 701,872.35€ të barten për shpenzim në vitin fiskal 2025

Neni 1

- 1.1 Komuna e Suharekës gjatë vitit 2024 ka tejkalluar planin buxhetor të të hyrave vetanake edhe për pjesën e inkasimit të denimeve të gjykatave, trafikut dhe pyjeve në shumë prej = **701,872.35€**.
- 1.2 Në vitin 2024, të hyrat vetanake kanë qenë të planifikuara, **2,252,469.00€**, ndërsa gjatë tërë vitit fiskal 2024, janë grumbulluar gjithsej shuma prej **2,954,341.35€**.
- 1.3 Mjetet e grumbulluara si tepriçë prej **701,872.35€** dhe shuma e pa shpenzuar që duhet bartur në vitin fiskal 2024 prej **701,872.35€** e si total i bartjes së të hyrave vetanake të tejkalluara sipa planifikimit buxhetor 2024.
- 1.4 Shuma prej **701,872.35€** duhet të bartet në programin e SIMFK-së, dhe të lejohet për alokim dhe shpenzim, në këto programe buxhetore dhe projekte kapitale si më poshtë;

Tabela 1

Programet/nënprogramet	Mallra dhe Sherbime	Subvencione dhe Transfere	Invstime Kapitale	TOTAL:
Sherbimet Publike dhe Emergjente (18012)	-		224,000.00	224,000.00
Bujqësia dhe Zhvillimi Rural (47012)	-	-	236,000.00	236,000.00
Planifikim e Urbanizëm (66365)	80,872.35			80,872.35
Administra e Shëndetësisë (73021)	-	30,000.00		30,000.00
Kultur Rini e Sport (85012)	-	75,000.00	56,000.00	131,000.00
TOTAL:	80,872.35	105,000.00	516,000.00	701,872.35

Lista e projekteve kalitale sipas njësive buxhetore për bartje nga viti 2024 do të barten në vitin fiskal 2025 për shpenzim

Tabela 2.

Nr. Rendor	EMRI I PROJEKTIT	FINANCIMI NGA BARTJA 2024
1	52714 – NDËRTIMI DHE RREGULLIMI I KOLEKTORIT NE RRUGËN SKËNDERBEU – SUHAREKË	
	Gjithsej; Shërbime Publike dhe Emergjencë - Infrastruktuerë rrugore (18012)	224,000.00
		224,000.00
1	52616- Projektet me bashkëfinancim	
	Gjithsej : Bujqësi dhe Zhvillim Rural (47012)	236,000.00
		236,000.00
1	54173-Ndërtimi i fushave sportive në Sopijë dhe Komunë	
	Gjithsej : Shërbimet Kulturore (85012)	56,000.00
		56,000.00
	TOTALI KOMUNAL :	516,000.00 €

Arsyetim

Shuma prej **701,872.35€** duhet të bartet në programin e SIMFK-së, dhe të lejohet për alokim dhe shpenzim, në këto programe buxhetore dhe projekte kapitale.

Mjetet e grumbulluara më shumë se planifikimi janë të hyrat e grumbulluara vetanake dhe nga dënimet e trafikut dhe Gjykatave, Pyjeve në shumë prej **504,247.73€** e të cilat ekskluzivisht shkojnë për projekte kapitale si dhe shuma prej **197,624.62€** janë mjete të realizuara nga THV tepriçë sipas planifikimit buxhetor 2024, e të cilat do shpërndahen sipas këtij vendimi në këto kategori ekonomike: Në **“Mallra dhe shërbime”** shuma prej **80,872.35€** në Drejtorin e Planifikimit dhe Urbanizmit (66365) pasi që ka obligime të papaguara ndaj OE sipas faturave të paraqitura në RVF 2024.

Në **“Subvencione dhe transfere”** shuma prej **105,000.00€** dhe atë në: Drejtorin e Administratës së shëndetësisë (73021) shuma prej **30,000.00€** pasi që kemi obligime të papaguara ndaj OE sipas faturave të paraqitura në RVF 2024.

Drejtoria Kulturë Rini dhe Sport (85012) shuma prej **75,000.00€** pasi që kemi obligime të papaguara ndaj OE sipas faturave të paraqitura në RVF 2024.

Në kategorinë e projekteve kapitale shuma prej 516,000.00€, shkon për projekte :
Shërbimet Publike dhe Emergjencë (18012) në shumë prej 224,000.00€

Ndërtimi dhe rregullimi i Kolektorit në rrugën "Skënderbeu"- Suharekë, kodi i projektit(52714) shuma prej **224,000.00€** mjete të pa alokuara në 2024 nga teprica e THV-së nga pjesa e dënimeve të trafikut, gjykatave dhe pyjeve në shumë prej **224,000.00€** e që janë obligime kontraktuale të mbetura nga viti i kaluar.

Bujqësia dhe Zhvillimi Rural (47012) në shumë prej 236,000.00€

Në projektin me kod (52616) **“Projektet me Bashkëfinancim”** shuma prej **236,000.00€** do të financohet nga pjesa e mbetur e THV-së prej dënimeve të trafikut, gjykatave dhe pyjeve shuma prej **236,000.00€** e që janë obligime kontraktuale të mbetura nga viti i kaluar.

Shërbimet Kulturore Rini dhe Sport (85012) në shumë prej 56,000.00€

Në projektin **“Ndërtimi i fushave sportive në Sopijë dhe Komunë”** me kodin(57173) nga pjesa e mbetur e THV-së prej dënimeve të trafikut, gjykatave dhe pyjeve shuma prej **56,000.00€** e që janë obligime kontraktuale të mbetura nga viti i kaluar.



Për kategoritë ekonomike “Mallrat dhe shërbime” Subvencione dhe transfere’ është shfrytëzuar teprica e THV-së realizuar mbi planifikimin buxhetor të vitit fiskal 2024 me qëllim të mos ndryshimit të strukturës së shpenzimeve konform Ligjit mbi ndarjet buxhetore 2024.

Projektet në fjalë janë edhe në Listën e projekteve kapitale 2024 që financohen nga GQ dhe THV, kurse pjesa nga THV e bartura do jetë si shtesë e mjeteve për projektet në fjalë nga të hyrat e tejkaluara sipas planifikimit si rrjedhojë e THV tepricë dhe nga dënimet e trafikut, Gjykatave dhe Pyjeve, por që nga këto shtesa punimet për projektet e lartcekura të mbetura si obligime kontraktual e të cilat priten të përfundoj gjatë vitit fiskal 2025.

Neni 2

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës, përkatësisht Drejtoria për ekonomi, financa dhe buxhet në bashkëpunim me Drejtorin për shërbime publike dhe emergjencë e Komunës së Suharekës.

Neni 3

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 30, ditë pas dërgimit në organin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8, lidhur me neni 9, të Ligjit Nr. 08/L-284, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, publikuar në “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 24/2024” dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve dhe faqen zyrtare të Komunës.

Neni 4

Pas hyrjes në fuqi të këtij vendim shfuqizohet vendimi 01-Nr-016-7445 i datës 30.01.2025 dhe ky vendim do të shërbej për bartjen dhe alokimin e mjeteve vetanake si tepricë të realizuara nga plani buxhetor i vitit 2024, e të cilat do të barten alokohen në SIMFK dhe shpenzohen gjatë vitit fiskal 2025.

KUVENDI I KOMUNËS – SUHAREKË

01-Nr- 06-25006
Më datë 29-04-2025



Kryesuesi i Kuvendit

Mr.ec Bexhet KUÇI

